



SOT (E MËRKURË) PRITET TË MERRET NJË PREJ VENDIMEVE MË
TË RËNDËSISHME NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-së

SOT 'DITA D' PËR LIDERËT E UÇK-së



Procesi maratonik gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është duke shkuar drejt fundit. Sot (e mërkurë) pritët të merret një

prej vendimeve më të rëndësishme në këtë proces gjyqësor: ai për mocionin e avokatëve për rrëzimin e disa prej akuzave ndaj katërshes së UÇK-së. Mbrojtja e

liderëve të UÇK-së ka vlerësuar se disa prej akuzave të ZPS-së nuk janë vërtetuar as përtej dyshimit të bazuar, andaj kanë kërkuar hedhjen e tyre poshtë

AKTUALE



REFUZOHET KËRKESA E HAXHI SHALËS PËR LIRIM ME KUSHT F. 7

AAK-ja ZYRTARIZON KANDIDATËT PËR KRYETARË TË KOMUNAVE F. 5

BUJA REAGON PAS VENDIMIT TË THEMELORES: I PABAZË, TENTIM PËR TË MË NDALUAR NË RRUÇËTIMIN POLITIK PËR LIPJANIN F. 7

EKONOMI



IKD-ja KËRKON RIKTHIMIN E MINISTRIË SË PUNËS: 85 PËR QIND E SHTETEVE TË BE-së E KANË KËTË MINISTRI TË VEÇANTË F. 8

KEK-u: PRODHIMI TEJKALON KËRKESËN PËR ENERGJI ELEKTRIKE F. 8

SPORT



KLUBËT E HENDBOLLIT MËSOJNË KUNDËRSHTARËT NË GARAT EVROPIANE F. 10

GAZETA GJERMANE SHKRUAN PËR PASOJAT E BLOKIMIT TË KUVENDIT: KURTI NUK SHIHET I GATSHËM PËR KOMPROMIS F. 7



SIGURIA DHE KRIZA INSTITUCIONALE, TEMË DISKUTIMI MES LIDERËVE ME EMISAREN BRITANIKE



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Merzi mirëpret vendimin e Trumpit për t'i dërguar armë Ukrainës

BERLIN, 15 KORRIK - Kancelari gjerman Friedrich Merz ka mirëpritur planet e presidentit amerikan Donald Trump për ta furnizuar Ukrainën me armë “në shkallë të gjerë”.

“Presidenti Trump dhe unë e kemi diskutuar këtë disa herë gjatë ditëve të fundit. E kam siguruar: Gjermania do të luajë një rol aktiv”, ka shkruar Merz në platformën “X”. Trumpi ka thënë se do të dërgojë sisteme mbrojtëse ajrore “Patriot” për ta ndihmuar Kievin që të mbrohet nga Rusia, por se kostot do të mbulohen nga Bashkimi Evropian.

Më herët Merzi ka shprehur gatishmërinë e Gjermanisë për të blerë sisteme “Patriot” nga ShBA-ja për Ukrainën. Raportohet se bëhet fjalë për dy sisteme, ndërsa një tjetër

do të financohet nga Norvegjia. Ukraina ka bërë me dije se ka nevojë për gjithsej dhjetë sisteme të tilla. “Po e bëjmë këtë për interesin tonë. Kjo do t'i ndihmojë ukrainasit të mbrohen nga terrori i bombardimeve ruse. Vetëm në këtë mënyrë do të rritet presioni mbi Moskën që të ulet në bisedime për paqe. Në fund të fundit, po tregojmë se jemi të bashkuar si partnerë në politikën e sigurisë”, ka thënë Merz. Sipas tij, tani janë duke u sqaruar detajet, ndërsa qeveria gjermane është në kontakt me partnerët ndërkombëtarë.

Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, gjendet në Uashington për bisedime mbi këtë çështje. Pistorius, pas takimit me sekretarin amerikan të Mbrojtjes, Pete



Hegseth, ka thënë se dërgimi i dy sistemeve “Patriot” në Ukrainë është në përgatitje e sipër. Ai ka thënë se dorëzimi

do të financohet nga Gjermania, por se detajet e fundit teknike, logjistike dhe financiare ende duhet të

sqarohen. Ukraina ka nevojë urgjente për sisteme shtesë të mbrojtjes ajrore, ka theksuar Pistorius.

Mediumi britanik: Trumpi i ka kërkuar Zelenskyt ta sulmojë Moskën dhe Shën Petersburgun



Londër, 15 korrik - “Financial Times (FT)” ka dalë të martën me një raportim të ri dhe shumë interesant në lidhje me luftën Rusi - Ukrainë dhe qëndrimin e presidentit amerikan Donald Trump. Sipas medias prestigjioze britanike, presidenti Trump e ka inkurajuar liderin ukrainas Volodymyr Zelenskyy që të marrë në konsideratë sulme më të thella brenda territorit rus, përfshirë kryeqytetin Moskë dhe qytetin strategjik Shën Petersburg. Duke cituar “persona të informuar për diskutimet” dhe një telefonatë mes liderëve më 4 korrik, “FT” ka shkruar se Trumpi i ka thënë Zelenskyt: “A mund të godasësh

Moskën?... A mund të godasësh edhe Shën Petersburgun?” Ndërkohë, sipas raportimit, Zelensky i është përgjigjur: “Absolutisht. Mundemi, nëse na jepni armët”. Këto detaje bien në kundërshtim të fortë me deklaratat e mëparshme të Trumpit mbi luftën në Ukrainë, kur dihet se gjatë fushatës së tij ai është zotuar t'i “mbyllë konfliktet jashtë vendit” dhe ka kritikuar përfshirjen e ShBA-së në luftën kundër Rusisë. Megjithatë, kujtojmë se një ditë më parë Trumpi ka realizuar një marrëveshje me NATO-n për Ukrainën, ku u vendos dërgimi i armëve të SHBA-së, të financuara nga BE, në ndihmë të saj.

Serbia dhe Kina do të kryejnë stërvitje të përbashkët ushtarake për herë të parë

PEKIN, 15 KORRIK - Serbia dhe Kina pritet të zhvillojnë stërvitje të përbashkët ushtarake për herë të parë kah fundi i këtij muaji, ka njoftuar Ministria kineze e Mbrojtjes. Pjesë e ushtrimeve të përbashkët “Paqeruajtësit 2025” do të jenë forcat speciale të Serbisë dhe Kinës dhe stërvitja do të zhvillohet në provincën Hebei në Kinën veriore.

“Kjo do të jetë stërvitja e parë e përbashkët midis ushtrive kineze dhe serbe. Do të

kontribuojë në forcimin e aftësive luftarake të pjesëmarrësve dhe thellimin e bashkëpunimit midis dy ushtrive”, ka thënë koloneli Jiang Bin, zëdhënës i Ministrisë kineze të Mbrojtjes në një konferencë për medie.

Serbia është ushtarakisht neutrale, por është anëtare e “Partneritetit për Paqe”, një program bashkëpunimi dypalësh midis NATO-s dhe vendeve individuale joanëtare. Beogradi zyrtar mban

marrëdhënie të mira me Kinën dhe këto dy vende e cilësojnë bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë si partneritet strategjik, ndërsa Serbia është kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Autoritetet në Beograd po mbështeten në përkrahjen e Kinës në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare në kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës. Serbia, gjithashtu, mbështeten te Kina për investime ekonomike dhe kredi.



SOT (E MËRKURË) PRITET TË MERRET NJË PREJ VENDIMEVE MË TË RËNDËSISHME
NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-së

SOT ‘DITA D’ PËR LIDERËT E UÇK-së

Procesi maratonik gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është duke shkuar drejt fundit. Sot (e mërkurë) pritet të merret një prej vendimeve më të rëndësishme në këtë proces gjyqësor: ai për mocionin e avokatëve për rrëzimin e disa prej akuzave ndaj katërsheve të UÇK-së. Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka vlerësuar se disa prej akuzave të ZPS-së nuk janë vërtetuar as përtej dyshimit të bazuar, andaj kanë kërkuar hedhjen e tyre poshtë

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 15 KORRIK - Procesi gjyqësor në rastin e liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, është duke shkuar drejt fundit. Sot (e mërkurë) pritet të merret një prej vendimeve më të rëndësishme deri në këtë fazë në rastin e katërsheve të UÇK-së. Fjala është për mocionin e avokatëve për rrëzimin e disa prej akuzave ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. Mbrojtja e liderëve të UÇK-së ka vlerësuar se disa prej akuzave të Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk janë vërtetuar as përtej dyshimit të bazuar, andaj kanë kërkuar hedhjen e tyre poshtë. Në fakt, mocioni dhe kërkesa e tyre ende nuk janë bërë publike. Megjithatë, vendimi do të shpallet në seancën e sotme. Po sot avokati i viktimave do ta paraqesë rastin e tij, me dy dëshmitarë-ekspertë që pritet të dëshmojnë.

Procesi gjyqësor në rastin e krerëve të UÇK-së tashmë ka hyrë në fazën e fundit, cilido që është vendimi për rrëzimin ose jo të akuzave. Krerët e UÇK-së kanë pasur kohë ta dorëzojnë mocionin për rrëzimin e akuzave deri më 12 qershor. Prokuroria e Specializuar e Hagës kishte kohë të përgjigjej në mocionin e mbrojtjes deri më 7 korrik. Gjyqtarët pritet ta shpallin vendimin sot (e mërkurë), më 16 korrik. Varësisht se cili do të jetë vendimi lidhur me mocionin, pritet të vazhdojë edhe procesi gjyqësor. Megjithatë, deri atëherë janë caktuar edhe disa data të tjera me rëndësi. Një konferencë për



ecurinë e çështjes do të mbahet të martën, më 22 korrik, në orën 14:00.

Avokati i viktimave është urdhëruar të përgatitet që t'i ftojë dëshmitarët e tij më 16 korrik. Mbrojtja e liderëve të UÇK-së duhet ta njoftojë Gjykatën Speciale deri më sot, 16 korrik, nëse synon t'i dorëzojë provat e veta. Mbrojtja duhet t'i dorëzojë provat dhe listat e dëshmitarëve deri më 21 korrik. Gjyqtarët kanë vendosur që konferencën statusore për rastin e mbrojtjes ta shtyjnë deri më 19 gusht. Rasti i mbrojtjes pritet të fillojë menjëherë pas 18 gushtit, varësisht se si përcaktohen afatet. Konferenca përgatitore për rastin e mbrojtjes mbahet më 19 gusht. 20 deri në 25

dëshmitarë pritet t'i ketë mbrojtja e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare në Gjykatën Speciale të Hagës. Prej tyre, rreth 15 mund të ftohen për të dëshmuar “live” në gjykatë. Është raportuar në medie se mbrojtja e Thaçit mund të thërrasë deri në 12 dëshmitarë që do të dëshmojnë në gjykatë, por që edhe ky numër mund të reduktohet. Kurse mbrojtja e Jakup Krasniqit do t'i ketë 10 dëshmitarë, prej të cilëve maksimalisht pesë do të dëshmojnë në Gjykatën Speciale. Aktualisht, mbrojtja e Veselit dhe Selimit nuk kanë planifikuar të ftojnë dëshmitarë. Procesi gjyqësor maratonik ndaj liderëve të UÇK-së ka nisur më 3 prill të vitit 2023. Në këtë proces

gjyqësor kanë dhënë dëshmitë e tyre një numër i madh i dëshmitarëve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), ku shumica e tyre kanë dëshmuar nën masat mbrojtëse. Ndërsa ata që kanë dëshmuar në publik, dëshmitë e tyre, sipas njohësve të drejtësisë, kanë qenë të zbehta. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Ata kanë bërë disa herë kërkesa për lirim me kusht, por nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Speciale.

Që nga fillimi i procesit gjyqësor janë larguar disa nga avokatët kryesorë për shkak të çështjeve financiare. Për këtë

çështje janë kritikuar ashpër institucionet e Kosovës të cilat që nga fillimi i këtij procesi gjyqësor janë duke u drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

Së fundmi, akademik Arsim Bajrami ka thënë se shteti i Kosovës ka dështuar t'i mbrojë liderët e UÇK-së që janë duke u gjykuar në Hagë. Specialja, ka thënë ai, nuk është duke u gjykuar ata individualisht. “Kosova nuk e ka ndjekur shembullin kroat”, ka thënë Bajrami. Në rastin e Kroacisë, ai ka thënë se “komplet shteti ka qenë i mobilizuar”. “Ka pasur zyrë të konsulencës, ka pasur shoqata, është financuar Akademia, është financuar Universiteti, shoqëria civile dhe mediet për ta mbrojtur luftën”, ka thënë Bajrami.

Osmani në Letoni: Ndikimi i Rosisë në Kosovë është zero



RIGA, 15 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në një konferencë për medie pas takimit me presidentin e Letonisë, Edgars Rinkeviq, është pyetur për raportin e Kosovës me Serbinë dhe për përpjekjet destabilizuese të Rosisë. Duke folur për influencën ruse, presidentja Osmani ka thënë se “influenca e Rosisë në Kosovë është zero”. Më tutje, presidentja Osmani ka thënë se këtë gjë s'mund ta thotë për shtetin e Serbisë. “Ne nuk duhet t'i fusim kurrë agresorin dhe viktimën në të njëjtin thes. Serbia përpiqet

vazhdimisht ta destabilizojë vendin tonë, përfshirë përmes akteve të agresionit, ndërsa ne mbrohemi vazhdimisht. Ne kurrë nuk kemi pushtuar ose sulmuar, madje as edhe një centimetër të territorit të ndonjë fqinji. Ajo çfarë kemi bërë gjithmonë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë, është ta mbrojmë pavarësinë tonë, ta mbrojmë integritetin tonë territorial, t'i mbrojmë paqen dhe lirinë, që janë fituar me shumë sakrificë”, ka thënë Osmani.

Ndërsa presidenti i Letonisë, Edgars Rinkeviq, ka thënë se

vizita e Osmanit është historike, duke shtuar se në takim ka konfirmuar mbështetjen për Kosovën në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian (BE). “E dimë se çfarë duan miqtë tanë në Kosovë, gjithashtu e dimë se ka ende shumë për t'u bërë si në aspektin e reformave të brendshme, po ashtu edhe në planin e politikës së jashtme, për ta siguruar mbështetjen e të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Por, dita kur Kosova do të bëhet vend kandidat është afër, edhe pse kërkohet ende shumë punë”, ka thënë presidenti i Letonisë.

Çitaku: Kosova është më e madhe se egoja e Kurtit dhe ambicia e Haxhiut

PRISHTINË, 15 KORRIK - Sekretarja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku, ka kritikuar ashpër qasjen e Vetëvendosjes në raport me krizën politike në vend. Ajo ka thënë se Kosova është më e madhe se egoja e Albin Kurtit dhe ambicia e Albulena Haxhiut për t'u bërë kryetare me çdo kusht edhe pse nuk i ka votat.

"Kosova është shumë më e madhe sesa egoja e Albin Kurtit dhe ambicia e Albulena Haxhiut", ka thënë ajo.

Çitaku ka theksuar se PDK-ja nuk i ka ikur asnjë takimi dhe ka qenë gjithmonë e hapur për bashkëpunim por, sipas saj, koha e fjalëve ka kaluar. "Nëse Kurti vazhdon ta përdorë kryeneçësinë si instrument politik, takimet janë të kota. LV-ja nuk ofron zgjidhje, por nënshtrim dhe PDK-ja nuk do t'i nënshtrohet liderit suprem. PDK-ja asnjëherë nuk u ka ikur takimeve, gjithmonë ka qenë e hapur për bashkëpunim dhe konstruktivitet. Por, fatkeqësisht, tashmë ka kaluar

koha e fjalëve. Është koha e veprimeve. Ne mund të takohemi pafundësisht, mirëpo nëse Kurti diktatin dhe kryeneçësinë vazhdon ta shndërrojë në instrument politik, atëherë takimi është i kotë. Ne nuk i kemi ikur asnjë lloj takimi. Është për keqardhje mënyra sesi po e trajtojnë Kuvendin e Kosovës. LV nuk e ka ofruar asnjë zgjidhje. Ka ofruar nënshtrim dhe PDK nuk i nënshtrohet diktatit të liderit suprem", ka thënë Çitaku.



KUVENDI I KOSOVËS S'GJEN RRUGËDALJE, 47 DËSHTIME RADHAZI

PRISHTINË, 15 KORRIK - Për të 47-n herë me radhë përpjekja për konstituimin e Kuvendit të Kosovës ka përfunduar pa sukses. Edhe kësaj radhe mbledhja e deputetëve të zgjedhur nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në ngërçin politik që është duke zgjatur tash e tre muaj.

Partitë deri më tash në opozitë, PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja dhe Lista Serbe, kanë refuzuar t'i propozojnë anëtarët për komisionin që duhet ta organizojë votimin e fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. Ata janë duke e konsideruar këtë procedurë të papajtueshme me Kushtetutën dhe e kanë kundërshtuar në mënyrë të përsëritur.

Lëvizja Vetëvendosje, fituese e zgjedhjeve parlamentare të shkurtit, është duke insistuar se votimi i fshehtë është në përputhje me ligjin dhe kërkon që procesi të mos bllokohet më tutje. Emërimi i kandidatës së saj, Albulena Haxhiu, për kryetare të Kuvendit është hedhur disa herë në votim të hapur, por nuk ka marrë mbështetjen e nevojshme, pasi ish-opozita ka votuar kundër. Në seancën e 15 korrikut kryesuesi Avni Dehari ua ka ndërprerë fjalën deputetëve të PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, të cilët kanë nisur ta adresonin problemin e ngërçit.



Ndërkohë, më 26 qershor, Gjykata Kushtetuese ka vendosur që Kuvendi duhet të konstituohet brenda një afati 30-ditor, por pa sqaruar pasojat nëse ky afat nuk respektohet. Kjo ka hapur rrugë për interpretime të ndryshme nga partitë politike, të cilat mbeten të ndara në

qasjen e tyre ndaj zgjidhjes së situatës.

Javën e parë të korrikut, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive politike, me synimin për të gjetur një rrugëdalje nga bllokada institucionale. Pas përfundimit të konsultimeve,

ajo ka theksuar se konstituimi i Kuvendit brenda afatit 30-ditor, të vendosur nga Kushtetuesja, nuk është çështje vullneti, por obligim kushtetues.

Osmani u ka bërë thirrje partive të angazhohen seriozisht për të gjetur një zgjidhje sa më parë. Këshilltari

i saj për medie, Bekim Kupina, ka thënë se presidentja është duke shqyrtuar mundësitë ligjore për t'i drejtuar një kërkesë sgaruese Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që të kuptohen pasojat juridike në rast se Kuvendi nuk konstituohet brenda afatit të dhënë.

Siguria dhe kriza institucionale, temë diskutimi mes liderëve me emisaren britanike

PRISHTINË, 14 KORRIK - Emisarja britanike për Ballkanin Perëndimor, Karen Pierce, ka qëndruar për vizitë në Kosovë. Gjatë kësaj vizite ajo është takuar me liderët institucionalë dhe politikë.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka bërë me dije se me emisaren britanike kanë diskutuar për sigurinë, mbrojtjen dhe diplomacinë. Veç kësaj, sipas Kurtit, në takim është folur edhe

për Procesin e Berlinit. "Siguria dhe mbrojtja, diplomacia dhe industria kreative ishin pjesë e temave të bisedës, gjersa trajtuam edhe pritshmëritë mbi samitin e ardhshëm të Procesit të Berlinit që do të zhvillohet në Londër në tetorin e këtij viti. Mbretëria e Bashkuar mbetet një ndër aleatët më të fuqishëm të Republikës së Kosovës, për çka dhe shprehja mirënjohjen ndaj emisares Pierce për partneritetin

dhe përkrahjen e vazhdueshme ndaj shtetit tonë", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Përveç Kurtit, emisarja britanike është takuar edhe me liderin e PDK-së, Memli Krasniqi, atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Ata kanë bërë me dije se me emisaren britanike kanë biseduar për raportet e Kosovës me Britaninë dhe për krizën institucionale.



GAZETA GJERMANE SHKRUAN PËR PASOJAT E BLOKIMIT TË KUVENDIT: KURTI NUK SHIHET I GATSHËM PËR KOMPROMIS

PRISHTINË, 15 KORRIK - Bllokada në Kuvendin e Kosovës ka nisur të bëhet temë edhe në mediet botërore. Rreth përpjekjeve të pasuksesshme të Kuvendit ka shkruar gazeta gjermane “Frankfurter Rundschau”. Artikulli i shkruar nga Thomas Roser ka theksuar se faji pjesërisht është edhe te kryeministri në detyrë, njëherësh kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti. Në këtë shkrim përmendet edhe protesta me gomarë e organizuar para disa ditësh nga avokati Arianit Koci. “Njerëzit po trajtohen si gomarë nga përfaqësuesit e tyre”, kishte shpjeguar Koci. Dhe duket se afër është të bëhet edhe përpjekja e 50 për konstituimin e Kuvendit, e cila pritët të ndodhë të dielën e ardhshme. Autori gjerman ka përmendur faktin se Kurti nuk po shihet i gatshëm për kompromis. Gazeta në fjalë ka përmendur një nga një edhe pasojat e bllokimit. “Pasoja e bllokimit: Ndërsa inflacioni u rrit në 4.3 për qind në qershor, niveli më i lartë në dy vjet, asnjë legjislacion nuk është miratuar, asnjë marrëveshje ndërkombëtare nuk është ratifikuar, asnjë fond i miratuar dhe asnjë pozicion udhëheqës vakant në institucionet shtetërore nuk është plotësuar për më shumë se gjysmë viti”,



është thënë në artikullin e “Frankfurter Rundschau”. Sipas këtij artikulli, për opozitën Albulena Haxhiu është e papërshtatshme për kryetare të Kuvendit. “Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit partia e majtë populiste Vetëvendosje (LV), e udhëhequr nga kryeministri në largim Albin Kurti, doli qartë partia më e fortë me rreth 42 për qind të votave, por humbi shumicën absolute. Opozita e konsideron kandidaten e nominuar nga LV-ja dhe ish-ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, të papërshtatshme për këtë pozicion për shkak të qëndrimit të saj polarizues dhe po shtyn përpara një propozim alternativ. Megjithatë, kryeministri aktual Kurti nuk shihet as veçanërisht i gatshëm për kompromis dhe as si lojtar ekipi”, është thënë në artikullin e “Frankfurter Rundschau”. Edhe pse Haxhiu vazhdimisht ka dështuar ta sigurojë shumicën e kërkuar prej 61 votash në gjashtë përpjekjet e mëparshme zgjedhore, LV-ja deri më tani nuk ka bërë asnjë përpjekje për ta zëvendësuar kandidatin e saj. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka caktuar një afat deri më 26 korrik për anëtarët e Kuvendit për ta përmbushur afatin e tyre. Megjithatë, për ta shpërndarë Kuvendin për zgjedhje të parakohshme, ai së pari duhet të konstituohet.

AAK-ja ZYRTARIZON KANDIDATËT PËR KRYETARË TË KOMUNAVE

PRISHTINË, 15 KORRIK - Këshilli i Përgjithshëm i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka nominuar kandidatët për kryetarë të komunave për zgjedhjet e 12 tetorit. AAK-ja ka bërë me dije se kryetari i kësaj partie, Ramush Haradinaj, me votë unanime ka miratuar nominimet e pesë kandidaturave të fundit për kryetarë komunash, nisur nga Enver Hoti, ish-anëtar i Nismës, i cili do të jetë kandidat për kryetar të Malishevës, Hafize Sallahu për Kaçanik, Mensut Ademi për Vushtrri, Ali Krasniqi për Obiliq dhe Beqir Kiqina për Drenas, me të cilët është mbyllur cikli i kandidaturave të Aleancës për zgjedhjet lokale 2025. Aleanca më herët kishte zyrtarizuar kandidaturat për 19 komuna të tjera. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se “AAK-ja hyn në këto zgjedhje e bashkuar, me energji të re dhe me besim të plotë në përkrahjen qytetare”. Kjo është lista e kandidatëve të AAK-së për kryetarë komunash që, sipas Haradinajt, “përbëhet nga figura të dëshmuara, që

kanë pas vetes jo vetëm përvojë, por edhe rezultate konkrete në shërbim të qytetarëve”.
Emrat e kandidatëve të AAK-së për kryetarë të komunave:
Ardian Gjini - Gjakovë
Ali Berisha - Pejë
Bali Muharremaj - Suharekë
Smajl Latifi - Rahovec
Zenun Elezaj - Klinë
Bashkim Ramosaj - Deçan
Bekë Berisha - Prishtinë
Ajet Avdyli - Novobërdë
Nazim Gagica - Gjiilan
Besnik Krasniqi - Prizren
Xhemile Murati - Ferizaj
Qazim Nimani - Mitrovicë
Faton Jakupi - Kamenicë
Ukë Blakaj - Istog
Agron Kuçi - Junik
Vildane Latifi - Fushë-Kosovë
Baki Feta - Podujevë
Labinot Bislimi - Viti
Ilir Tasholli - Lipjan
Hafize Sallahu - Kaçanik
Mensut Ademi - Vushtrri
Ali Krasniqi - Obiliq
Beqir Kiqina - Drenas



KULTURA E MUNGUAR E PËRGJEGJËSISË: PSE DORËHEQJET MORALE JANË TË RËNDËSISHME?



PRISHTINË, 15 KORRIK - Dorëheqja morale nuk është e kërkuar me ligj, por reflekton nivelin e integritetit të institucioneve. Në Kosovë ky akt mbetet i rrallë dhe shfaqet kryesisht pas presionit publik.

Tahir Latifi, profesor i Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se përgjegjësia morale shkon përtej lidhjes së drejtpërdrejtë me një dëm apo mossaues institucional. Ajo është pjesë e rolit udhëheqës, ka thënë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Javën e kaluar komandanti i Policisë së Kosovës për rajonin e Lipjanit, Argjend Gashi, ka dhënë dorëheqje nga pozita vetëm pak ditë pas vdekjes së një 27-vjeçari gjatë arrestimit nga policia. Ai e ka bërë kërkesën për lirim nga detyra dhe ajo i është miratuar, pasi pesë policë janë paraburgosur nën dyshimet për “vrasjen nga pakujdesia” të të iut, Agon Zejnullahu.

Latifi, njohës i strukturës dhe organizimit shoqëror, ka thënë se dorëheqja e tillë e një drejtuesi institucional dërgon te publiku një mesazh gatishmërie për të marrë përgjegjësi, qoftë morale dhe pa përgjegjësi ligjore dhe për të mos ndikuar në proceset hetimore ose ligjore që janë në zhvillim. “Dorëheqja morale fillon ta rrisë besimin te qytetarët, duke treguar se njerëzit në institucione kanë nisur të ndjejnë njëfarë përgjegjësie. Pra, publikut i thotë se ‘ne po e pranojmë se është bërë një dëm - edhe nëse nuk kemi përgjegjësi direkte’”, ka shpjeguar Latifi.

Ai ka theksuar se veprimi i tillë ndihmon edhe në uljen e tensioneve në situata që kërkojnë përgjegjësi nga

udhëheqësit institucionale, por nënvizon se kjo praktikë në Kosovë është e rrallë.

Nga tragjedia te dorëheqja: Rastet e rralla në Kosovë

Një shembull i fundit i dorëheqjes morale është edhe rasti i asamblistit të Komunës së Prizrenit, Shukri Quni, më 2 qershor. Akti i tij ka pasuar një aksident automobilistik fatal në Nashec, fshat i kësaj komune, ku kishte humbur jetën një 17-vjeçar. Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, Quni ka treguar se e kishte ngritur më herët në Kuvendin Komunal çështjen e mungesës së sinjalistikës rrugore në atë zonë dhe, pas tragjedisë, thotë se ndjeu obligim moral të largohej nga pozita. “Kur ti flet dhe fjala jote nuk zë vend, nuk merret parasysh, pse rri kot atëherë? E kam ndjerë obligim moral të jap dorëheqje, aty për aty, madje pa filluar mirë seanca. Nuk kam lejuar të diskutohet rendi i ditës - menjëherë kam dhënë dorëheqje dhe kam dalë jashtë”, ka thënë Quni.

Për të ky veprim ishte përgjegjësi ndaj qytetarëve, sidomos atyre që e kishin votuar. Në vitin 2022, dorëheqje morale kishte dhënë edhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, pas rastit të përdhunimit të një 11-vjeçarjeje në Prishtinë nga pesë persona të dyshuar. Po për këtë rast, nga pozita ishte vetëdijshëm edhe udhëheqësi i Drejtorisë për trajtimin e të burgosurve dhe të miturve në Shërbimin Korrektues të Kosovës, Ali Gashi.

Në vitin 2016 Xhelal Sveçla, asokohe drejtor i Inspektoratit në Komunën e Prishtinës, kishte dhënë gjithashtu dorëheqje, pas vdekjes së dy fëmijëve në një pus të thellë të mbushur me ujë në lagjen Kolovicë. Vdekja e dy fëmijëve ishte aksidentale, sipas Policisë së Kosovës, por Sveçla kishte thënë: “nuk ndjej përgjegjësi ligjore, por njerëzore po”.

Sveçla, aktualisht ministër në detyrë i Punëve të Brendshme dhe është pyetur nga gazetarët nëse do të japë dorëheqje pas rastit në Lipjan, por nuk është përgjigjur.

Mbi 18 vjet më parë, në shkurt të 2007-s, dorëheqje kishte dhënë edhe ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme, Fatmir Rexhepi, pas vrasjes së dy personave në një protestë në Prishtinë. Mon Balaj dhe Arben Xheladini kishin humbur jetën pasi policia e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë kishte qëlluar me plumba gome në drejtim të protestuesve.

Rexhepi kishte thënë atëkohë se ndien përgjegjësi morale ndaj qytetarëve dhe familjarëve të viktimave, pavarësisht se forcat nuk ishin nën komandën e tij direkte.

Kur dorëheqja shihet si dobësi

Burbuqe Kastrati nga Lëvizja FOL, që promovon transparencën dhe llogaridhënien në institucionet publike, ka thënë se në vitet e pasluftës në Kosovë, dorëheqjet morale kanë qenë të rralla dhe jo pjesë e kulturës institucionale. Ajo ka thënë se aktet e tilla nuk nënkuptojnë pranim të fajsisë

ligjore për një ngjarje apo dëm publik. “Dorëheqjet morale duhet të interpretohen si akt i përgjegjësisë.

Kultura institucionale nuk nënkupton që institucionet të reagojnë vetëm kur janë nën presion, por të jenë llogaridhënëse para qytetarëve në çdo kohë”, ka thënë Kastrati për “Radion Evropa e Lirë”. Praktikën, sipas saj, tregojnë se bartësit institucionale zakonisht e shmangin përgjegjësinë kur përballen me dështime apo dëme të shkaktuara nga mosveprimi i institucionit.

Në nivelet politike, ajo ka thënë se dorëheqja morale perceptohet shpesh si “shenjë dobësie”. “Çka vërejmë te qytetarët në Kosovë, është se kjo mungesë e përgjegjësisë institucionale është një nga faktorët kyç të mosbesimit të qytetarëve në institucionet shtetërore në këso rastesh”, ka thënë Kastrati.

Një anketë e publikuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, korrikun e vitit 2024, ka nxjerr në pah se “mesatarisht 50.1 për qind e të anketuarve kanë qenë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore kryesore të Kosovës”.

Në vitin 2022, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë kishte publikuar po ashtu një raport, sipas të cilit, “besimi i qytetarëve në institucionet e gjykatave dhe prokurorisë në Kosovë është në rënie të vazhdueshme”. Sipas atij raporti, besim të plotë në prokurori kanë pasur 13 për qind e të anketuarve, ndërsa në gjykata 14 për qind. Besim më i theksuar në mesin e të anketuarve ka qenë në Policinë e Kosovës me 46 për qind.

Mentaliteti shoqëror dhe sfidat e ndërtimit të besimit

Latifi ka vlerësuar se mungesa e besimit më të madh të qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës lidhet më shumë me mentalitetin shoqëror, i cili e ka origjinën në të kaluarën. “Prej Perandorisë Osmane, 90 vjet Serbia, deri në fund të viteve ‘90 kur përfundoi lufta, pastaj administrimi ndërkombëtar... në shtetin e Kosovës nuk është arritur besimi i mjaftueshëm i qytetarit në institucion. Nuk është se ka humbur, por s’ka qenë asnjëherë”, ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se ndërtimi i një mentaliteti që e njeh përgjegjësinë institucionale si vlerë demokratike dhe kulturore, kërkon edukim të brezave të rinj, që nga arsimi fillor e tutje. E, mendim të ngjashëm ka ndarë edhe Kastrati. Përveçse në shkollë, ajo ka thënë se edukimi për përgjegjësinë institucionale duhet të bëhet edhe përmes medias dhe shoqërisë civile, duke rritur vetëdijen qytetare për të kërkuar llogaridhënie vazhdimisht dhe jo vetëm pas ngjarjeve tragjike. Sipas saj, transparenca e institucioneve është çelësi për ndërtimin e afërsisë dhe besimit me qytetarët. “Ne, si qytetarë, duhet të jemi të edukuar se këto janë institucione, të cilat duhet të na japin llogari dhe duhet të na shërbejnë për sigurinë dhe mirëqenien tonë të përbashkët”, ka thënë Kastrati. Raporte të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si Transparency International, tregojnë se në Evropë vendet skandinave prijnë në indeksin e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike.

REFUZOHET KËRKESA E HAXHI SHALËS PËR LIRIM ME KUSHT

HAGË, 15 KORRIK - Gjykata Speciale në Hagë ka refuzuar kërkesën e Haxhi Shalës, i njohur si komandant "Topi", për lirim me kusht. Vendimi është marrë nga kryetarja e kësaj gjykate, Ekaterina Trendafilova, më 14 korrik 2025. Sipas vendimit, Shala kishte parashtruar se kishte përmbushur gjysmën e dënimit më 11 qershor 2025 dhe se dy të tretat e tij do t'i përmbushte më 11 dhjetor 2025. Ai kishte thënë lirimi i tij duhej të shqyrtohej në përputhje me nenin 90 të Kodit Penal të Kosovës, i cili, sipas tij, e lejonte lirimin e tillë me kusht pas përmbushjes së gjysmës së dënimit të shqiptuar.

Shala ishte transferuar në Hagë në dhjetor 2023. "Z. Shala gjithashtu parashtrroi se zbatimi i nenit 90 të KPK-së do të plotësonte një boshllëk që rrjedh nga neni 51 (2) i Ligjit, i cili parashikon mundësinë e ndryshimit apo modifikimit të dënimit, duke qenë se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) nuk rregullon shprehimisht kur një ndryshim apo modifikim i tillë mund të jepet. Ai parashtrroi se rregulli i dy të tretave parashihet vetëm për uljen e dënimit, dhe neni 10 i Udhëzimit praktik nuk 'nënkupton se Kryetarja mund të modifikojë ose ndryshojë dënimin' vetëm nëse ulja e dënimit nuk është konsideruar e përshtatshme", është thënë në vendim.

Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte kundërshtuar këtë



qëndrim duke pretenduar se Shala po përpiket në mënyrë të gabuar ta zbatojë këtë nen në kundërshtim me Ligjin për DhSK-së. "ZPS më tej parashtrroi se dispozitat e KPK-së nuk plotësojnë asnjë boshllëk, pasi kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara parashikon posaçërisht uljen, modifikimin dhe ndryshimin e dënimeve", është thënë në vendim.

Në vendim është thënë se kryetarja e Speciales në disa raste të mëparshme kërkesat për shqyrtimin e uljes, modifikimit

apo ndryshimit të dënimit bëhen të pranueshme për shqyrtim vetëm në rast se kanë përmbushur dy të tretat e dënimit.

Ndërsa për argumentin e Shalës, se neni 90 i KPK-së është i zbatueshëm në Speciale, kryetarja ka thënë se nuk mund të mbështetet.

Kryetarja ka thënë se letrat e shkëmbyera në mes të Kosovës dhe BE-së, të ratifikuara në Kuvendin e Kosovës, parashikojnë që strukturat e DhSK-së do të rregullohen nga statusi dhe rregullat e tyre të

procedurës dhe provave, duke përfshirë edhe dispozitat për kufizimet në dhënien e faljeve, paraburgimit ose ekzekutimin e dënimeve jashtë vendit.

Kryetarja ka thënë në vendimin e saj se funksionimi i DhSK-së rregullohet ekskluzivisht me nenin 162 të Kushtetutës dhe kuadrit juridik lex specialist (që i referohet ligjit të veçantë për DhSK-në). Sipas kryetares Trendafilova, çdo ligj tjetër i Kosovës që nuk është përfshirë në Ligjin për DhSK-në nuk është i zbatueshëm. Si rrjedhojë,

kryetarja ka thënë në vendimin e saj se nuk qëndron pretendimi i Shalës se një boshllëk i supozuar në kuadrin juridik të DhSK-së plotësohet me nenin 90 të KPK-së. Në këtë kontekst është refuzuar kërkesa e Shalës si e papranueshme për shqyrtim pasi nuk i ka përmbushur dy të tretat e dënimit të tij.

Ndryshe, më 4 shkurt 2025, është shpallur aktgjykimi ndaj Shalës dhe ndaj dy bashkë të akuzuarve të tjerë (Ismet Bahtijarit dhe Sabit Januzit), me ç'rast trupi gjyqësor i ka pranuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë. Si rrjedhojë, Haxhi Shala është dënuar me tri vjet burgim dhe Bahtijari e Januzi me nga dy vjet.

Trupi gjyqësor kishte urdhëruar Shalën që të paguajë 400 euro për viktimën 1, ndërsa Januzin me 100 euro. Obligime financiare nuk janë përcaktuar për Bahtijarin. Ky obligim është kryer dhe viktimës më 17 shkurt 2025 i janë dorëzuar mjetet. Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari janë liruar me kusht. Vendimi për lirimin e tyre është marrë më 19 shkurt 2025, ndërsa lirimi u është mundësuar më 21 shkurt 2025.

Sabit Januzi, Haxhi Shala dhe Ismet Bahtijari pranuan fajësinë për veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe të frikësimit përmes një marrëveshje të arritur në mes tyre dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Kjo marrëveshje është arritur pak ditë para se të nisë gjykimi ndaj tyre në nëntor të 2024-s.

BUJA REAGON PAS VENDIMIT TË THEMELORES: I PABAZË, TENTIM PËR TË MË NDALUAR NË RRUGËTIMIN POLITIK PËR LIPJANIN

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kandidati i PDK-së për kryetar të Lipjanit dhe ish-komandanti i UÇK-së në Zonën e Nerodimes, Shukri Buja, ka reaguar publikisht ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila në rigjykim e ka lënë fajtor dhe e ka dënuar atë dhe nëntë të tjerë me një vit burgim për rastin e njohur si "Veteranët".

Ai ka thënë se ky vendim është i pabazë dhe është bërë në përpjekje për ta ndaluar rrugëtimin e tij politik për ta ndryshuar rrugën e gabuar që ka marrë Lipjani nën drejtimin e Imri Ahmetit. "Tentimi për të më ndaluar në rrugëtimin tim politik, përmes një vendimi të pabazë, qesharak dhe politik, është i dështuar që në nisje. Asgjë dhe askush nuk do ta ndalë përpjekjen time për të ndryshuar drejtimin e gabuar që ka marrë Lipjani. Unë kam respektuar dhe vazhdoj të respektoj organet e drejtësisë së Republikës së Kosovës, një shtet për të cilin kam sakrifikuar rininë time në burgjet



serbe, kam luftuar për çlirim së bashku me bashkëluftëtarët, kam

ndihmuar në ndërtimin e institucioneve, si dhe kam

shërbyer me përkushtim e përgjegjësi në komunën tonë", ka

thënë Buja.

Më tutje, Buja ka thënë se ky vendim nuk është i formës së prerë dhe se do ta vazhdojë betejën juridike. "Edhe kur drejtësia merr vendime të padrejta e të motivuara politikisht unë nuk i mohoj, por i sfidoj me dinjitet dhe në rrugë ligjore. Dua t'ju njoftoj se rrugëtimin tim politik për të udhëhequr Komunën e Lipjanit do ta vazhdoj me vendosmëri, sepse ligji nuk e ndalon kandidimin tim. Vendimi i Gjykatës Themelore nuk është i formës së prerë dhe për këtë arsye unë do të vazhdoj betejën ligjore deri në fund. U përballa me drejtësinë serbe, me drejtësinë ndërkombëtare dhe me sfida të shumta brenda institucioneve të shtetit tonë për më shumë se dy dekada dhe nga të gjitha dola i pastër dhe fitimtar. Kjo e fundit? Një betejë e vogël, qesharake dhe e motivuar politikisht, dhe si e tillë do të përfundojë atje ku u takon vendimeve të padrejta: në shportën e mbeturinave historike", ka thënë Buja.

IKD-ja KËRKON RIKTHIMIN E MINISTRISË SË PUNËS: 85 PËR QIND E SHTETEVE TË BE-së E KANË KËTË MINISTRI TË VEÇANTË

PRISHTINË, 15 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me mbështetjen e National Endowment for Democracy dhe Rockefeller Brothers Fund, të martën ka organizuar takim diskutues dhe ka publikuar raportin me titull “Ndikimi i bashkimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Ministrinë e Financave - analizë e reformës qeveritare në fushën sociale”.

Naim Jakaj, hulumtues i lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), ka kërkuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës rikthimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale si institucion i pavarur dhe i specializuar, duke theksuar se kjo është praktikë standarde në shumicën e vendeve evropiane.

“Sot 85 për qind e shteteve të Bashkimit Evropian e kanë një ministri të veçantë për punë dhe

mirëqenie sociale. Po ashtu, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor e ruajnë këtë strukturë si shtyllë të rëndësishme të qeverisjes. Vetëm Kosova dhe pjesërisht Shqipëria kanë zgjedhur ta fusin këtë fushë jetike brenda ministrive me portofol financiar, duke e humbur fokusin strategjik dhe përgjegjësinë institucionale për të drejtat sociale”, ka thënë Jakaj gjatë prezantimit të raportit.

Ai ka paralajmëruar se vendimi për shuarjen e MPMS-së ka dështuar të ofrojë reforma dhe ka rezultuar në marginalizimin e fushës sociale. “Kjo nuk është çështje teknike, por politike dhe sociale me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve”, ka thënë ai.

Jakaj ka kërkuar miratimin e ligjeve sociale të paproceduara, funksionalizimin e Këshillit për Dialog Social dhe Siguri në Punë,



si dhe nënshkrimin e kontratave kolektive për sektorin publik dhe privat. Ai nënvizoi se Kuvendi

duhet të mbajë më shumë interpelanca dhe seanca për këtë fushë të rëndësishme, ndërsa

qeveria të sigurojë raportim dhe llogaridhënie për politikat sociale.

GËRXXHALIU: SITUATA E KRIJUAR NË KOSOVË ËSHTË ANTIEKONOMIKE, PO HUMBIN MILIONA EURO



PRISHTINË, 15 KORRIK - Ekonomisti Safet Gërxhaliu ka deklaruar se Kosova është në një situatë shqetësuese në aspektin ekonomik, duke thënë se këtë po e shohin vetëm qytetarët. Gërxhaliu ka thënë për “Tëvë1” se Kosovës i mungon një diplomaci ekonomike. Ai ka shtuar se situata e krijuar tani në Kosovë është antiekonome pas, sipas tij, po dëmton imazhin e vendit dhe po humb miliona euro. Ai ka theksuar se të 47 dështimet për konstituimin e Kuvendit janë dëshmia më e mirë se politikanët janë të varur nga partia politike dhe interesat e tyre partiake. “Ky ngërç politik nuk duhet të analizohet vetëm nga dimensionin ekonomik, por duhet të analizohet në disa dimensione. Është dimensionin gjeostrategjik, integruar, social, ekonomik, mbi të gjitha është imazhi i Kosovës dhe aspekti psikologjik dhe falë një situatë të tillë të krijuar, Kosova është

në sanksione apo në masat e Bashkimit Evropian. Dhe që sa kohë nuk kemi institucione, atëherë vërtet rezultatet nga një ngërç i tillë politik janë shqetësuese. Kosova është në një situatë të palakmueshme në aspektin ekonomik. Dëmi që i bëhet Kosovës është më shumë se 1 miliard e 200 milionë euro në aspektin numerik, kurse në aspektin e imazhit e të jetuarit në Kosovë është vërtet një situatë shqetësuese. Imazhi i Kosovës është në pikën më kritike, mungon një diplomaci aktive qoftë politike apo ekonomike. Sot ky ngërç politik dëshmon se politikanët janë të varur nga partia politike dhe interesa të partive politike. Ky minimizim i lirisë të mendimit dhe veprimeve na ka sjellë në këtë qasje. Ambienti i krijuar në Kosovë është antiekonomi, antisektor privat dhe definitivisht po e dëmton imazhin e saj”, ka thënë Gërxhaliu.

KEK-u: Prodhimi tejkalon kërkesën për energji elektrike

PRISHTINË, 15 KORRIK - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se është duke vazhduar të sigurojë stabilitet energjetik për vendin.

Në njoftim është thënë se gjatë ditëve të para të muajit korrik 2025 prodhimi nga KEK-u jo vetëm që ka përmbyshur, por e ka tejkaluar kërkesën ditore të energjisë elektrike, me një mbulueshmëri që ka arritur deri në 117 për qind.

“Njësitë tona prodhuese, ndonëse të stërvjetëruara dhe me sfida teknike të trashëguara,

janë duke operuar me kapacitet të lartë, duke mundësuar mbulim të plotë të konsumit vendor dhe garantuar furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm për qytetarët e Kosovës”, ka njoftuar KEK-u.

Po ashtu, KEK-u ka bërë disa sqarime duke ritheksuar përkushtimin ndaj transparencës, zbatimit të ligjit dhe funksionimit normal të njësive energjetike.

“Faktet flasin vetë: Prodhimi energjetik është i qëndrueshëm dhe tejkalon kërkesën; Njësitë,

përfshirë A3, janë në funksion të rregullt dhe kontribuojnë ndjeshëm në sistem; Të gjitha procedurat e prokurimit zhvillohen sipas ligjit, nën mbikëqyrjen e institucioneve kompetente”, ka njoftuar KEK-u.

Ndër të tjera, KEK-u ka thënë se mbetet e hapur për bashkëpunim me publikun dhe institucionet relevante dhe fton që çdo komunikim të bazohet në fakte të verifikueshme, integritet dhe etikë profesionale.



SI IA DOLI GREQIA TË RINGRIHEJ NGA GREMINA EKONOMIKE

Në vitin 2011, Dimitra Plagkou përjetoi një nga momentet më të errëta të jetës së saj: e zhytur në borxhe, me biznesin e saj të falimentuar dhe shtëpinë në ankand nga banka, mendoi të vetëvritej. Rasti i saj tragjik është vetëm një nga mijëra që tregojnë dhimbjen e thellë të një shoqërie, që u përball me krizën më të rëndë ekonomike në një vend të zhvilluar pas Luftës së Dytë Botërore. Greqia u zhyt në një krizë të thellë borxhi në vitin 2010, kur u zbulua se të dhënat e deficitit buxhetor ishin manipuluar për vite me radhë. Kombinimi i borxhit të lartë publik, korrupsionit, administratës joefikase dhe mungesës së konkurrueshmërisë e çuan vendin në një rrugë pa krye. Tregjet financiare e humbën besimin, dhe interesat për borxhet u rritën në nivele të papërballueshme. U desh ndërhyrja e Bashkimit Evropian dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar për të shpëtuar shtetin grek nga falimentimi.

Në vitin 2015, referendumi i mbajtur për të refuzuar kushtet e huadhënësve ndërkombëtarë shkaktoi tronditje të tjera, dhe rreziku i daljes nga eurozona ishte më real se kurrë më parë. Retorika populiste e qeverisë së majtë të udhëhequr nga Alexis Tsipras ndeshi në realitetin ekonomik. Pas disa muajsh tensioni dhe përplasjesh me kreditorët, Greqia u detyrua të tërhiqej dhe të pranonte një paketë të tretë ndihme financiare, duke u angazhuar për reforma të thella strukturore. Rruga drejt rimëkëmbjes ishte e dhimbshme. Rreth 25% e prodhimit të brendshëm bruto humbi. Papunësia arriti mbi 27%, ndërsa shumë grekë humbën shtëpitë dhe kursimet e tyre të jetës. Emigrimi u shtua dhe besimi në institucionet shtetërore u dobësua ndjeshëm. Por, nga ky moment i errët, filloi dhe transformimi. Qeveria e re e zgjedhur në vitin 2019, e drejtuar nga partia e qendrës së djathtë Demokracia



e Re dhe kryeministri Kyriakos Mitsotakis, vendosi prioritet rindërtimin e besimit dhe stabilitetit ekonomik. Me përmirësime në mbledhjen e taksave, dixhitalizimin e shërbimeve publike, nxitjen e investimeve dhe liberalizimin e tregut të punës, Greqia filloi të përshpejtojë rritjen ekonomike. Në vitet që pasuan, borxhi

publik u menaxhua më mirë, ndërsa reformat strukturore dhe financiare u përshpejtuan. Vendi doli nga programet e ndihmës financiare dhe nisi të tërheqë kapital privat. Në 2022, rritja ekonomike e Greqisë ishte më e larta në eurozonë. Turizmi u rikthye fuqishëm, ndërsa teknologjia dhe sektori i energjisë së rinovueshme nisën

të luajnë rol gjithnjë e më të rëndësishëm në strukturën ekonomike. Megjithatë, sfidat mbeten. Produktiviteti është ende nën nivelin e vendeve të zhvilluara të BE-së, sistemi gjyqësor është i ngadaltë dhe burokracia ende pengon dinamikën e biznesit. Ndërkohë, rritja e kostove të jetesës dhe pasojat e pandemisë dhe luftës në Ukrainë kanë rritur presionin mbi qeverinë për të ruajtur ritmin e reformave. Por ndryshimi është i prekshëm. Qytetarët grekë, të lodhur nga krizat e njëpasnjëshme, sot ndihen më të sigurt ekonomikisht. Investitorët ndërkombëtarë po i rikthehen Athinës, ndërsa BE-ja e sheh Greqinë si një partner më stabil dhe më të përgjegjshëm. Siç e përmbledh ministri aktual i financave: “Po flasim për një ekonomi krejt tjetër nga ajo që trashëguam në vitin 2019. Sot, kemi rikthyer stabilitetin fiskal dhe jemi në rrugën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.” / bota.al

“OH, VËRTET? SAPO ËSHTË SULMUAR QYTETI TJETËR” - MELANIA TRUMP MUND TË KETË NDRYSHUAR RRJEDHËN E LUFTËS NË UKRAINË

Kthesa e madhe e Donald Trump për Ukrainën!

Presidenti i SHBA tani po i shoqëron fjalët e ashpra ndaj despotit të Kremlinit, Vladimir Putin, edhe me veprime — siç e shpalli të hënë në Zyrën Ovale, përkrah sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte. Një rol vendimtar në këtë kthesë mund të ketë luajtur edhe bashkëshortja e Trumpit, Melania Trump, siç la të kuptohej vetë presidenti amerikan... Në praninë e Rutte-s, ai kërcënoi aleatët e Rusisë me tarifa ndëshkuese prej 100 përqind. “Do të vendosim tarifa shumë të ashpra, nëse nuk arrijmë një marrëveshje (për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë) brenda 50 ditësh,” tha Trump. I pyetur nga gazetarët, presidenti amerikan konfirmoi se ishte “i zhgënjyer nga Putini”. Sipas tij, udhëheqësi i Kremlinit nuk i kishte mbajtur premtimet. Rutte konfirmoi gjithashtu kthesën në politikën e armatimit nga ana e Trump. NATO dhe SHBA janë dakordësuar për dërgesa "masive" armësh për Ukrainën, të cilat do të financoheshin nga vende evropiane si Gjermania. Kthesa e Trump është një “hap i



rëndësishëm, edhe pse befasues,” tha politologu Jonathan Cristol për BILD. Megjithatë, ai sheh një pengesë të madhe: “Zbatimi i këtyre porositë kërkon kohë”. Kohë, gjatë së cilës Putini mund të vazhdojë ofensivën e tij verore kundër Ukrainës. Kjo do të thotë, sipas vlerësimit të Cristol: Edhe pas kthesës së planifikuar të Trump për armatosjen, Ukraina mund të “mbajë kryesisht frontin, por vështirë se ta fitojë luftën”. Një person që mund të ketë luajtur rol vendimtar në shkëputjen e Trump nga Putini: bashkëshortja e tij, Melania. Gjatë konferencës për shtyp, presidenti amerikan përmendi papritur, në mënyrë befasuese, Zonjën e Parë. Kur Trump bisedoi së fundmi me udhëheqësin e Kremlinit, Putin, ishte i bindur se kishte pasur një “bisedë të shkëlqyer”. Por kur i tregoi Melanisë për atë që ai e konsideronte një sukses, ajo thjesht i tha: “Oh, vërtet? Sapo është sulmuar qyteti tjetër”. Trump shtoi: Në një moment, bisedat nuk do të mjaftojnë më, “në një moment duhet veprim”. Nuk është e re që Trump kërkon këshilla dhe mbështetje nga familja e tij: veçanërisht fëmijët e tij luajnë rregullisht role të rëndësishme këshillimi. Megjithatë, bashkëshortja Melania ka qëndruar gjithmonë larg politikës. (BILD)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Trumpi e mori trofeun e Botërorit të Klubeve, Chelsea vetëm kopjen

NJU-JORK, 15 KORRIK - Një prapaskenë e pazakontë ka dalë në dritë pak ditë pas përfundimit të Kupës së Botës për Klube në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ish-presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se është ai që ka në zotërim trofeun origjinal të turneut,

ndërkohë që Chelsea, fituesja e finales, ka marrë vetëm një kopje të tij. Sipas rrëfimit të bërë nga vetë Trumpit për mikrofonat e DAZN, FIFA ia dorëzoi atij trofeun për ruajtje përpara nisjes së kompeticionit, duke e vendosur në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë. Por kur ka

pyetur se kur do ta tërhiqnin, përgjigjja e presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, e ka befusuar tërësisht: “Nuk do ta marrim kurrë. Mund ta mbash përgjithmonë”. Kjo ka forcuar bindjen e Trumpit se ai është në zotërim të trofeut të vërtetë. Këto ishin fjalët e tij: “FIFA më tha: ‘Mund

ta mbash këtë trofe për pak kohë?’ E vendosëm në Zyrën Ovale. Pastaj pyeta: ‘Kur do ta merrni mbrapsht?’, dhe Gianni Infantino më tha: ‘Nuk do ta marrim kurrë, mund ta mbash përgjithmonë’”. Deklarata që ka habitur opinionin sportiv dhe që lë të kuptohet se Chelsea mund të ketë festuar vetëm me



një kopje, ndërsa trofeu origjinal ndodhet ende në duart e ish-presidentit amerikan.

KLUBET E HENDBOLLIT MËSOJNË KUNDËRSHTARET NË GARAT EVROPIANE

“Epoka e re”

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kampioni i Kosovës në hendboll, Rahoveci, do ta nisë garimin në raundin e dytë të Kupës Evropiane për Hendbollistë (EHF European Cup). “Vreshtarët” do të përballen me fituesin e përballjes mes Dudelange nga Luksemburgu dhe Butelit nga Maqedonia e Veriut të cilat zhvillojnë ndeshjet në raundin e parë. Ndeshjet e raundit të dytë do të luhen më 11/12 tetor dhe ato të kthimit më 18/19 tetor. Ndërkohë, fituesi i Kupës së Kosovës, Kastrioti, do ta fillojë garën evropiane në raundin e dytë, ku do të përballlet me skuadrën nga Luksemburgu, Red Boys Differdange. Ndeshja



e parë do të zhvillohet në Luksemburg, ndërsa ajo e kthimit në Ferizaj. Edhe këto ndeshje janë planifikuar për 11/12 tetor dhe 18/19 tetor.

Edhe Besa Famgas ka mësuar kundërshtarin për raundin e parë të Kupës Evropiane. Skuadra pejane do të përballlet me ekipin turk Depsas Enerji,

me synimin për të kaluar në raundin e dytë të garës. Ndeshjet e këtij raundi do të luhen më 6/7 shtator dhe 13/14 shtator. Besa Famgas ka një përvojë të gjatë në garat evropiane dhe do të synojë të bëjë edhe një paraqitje të denjë në edicionin e sivjetmë. Kampioni i Kosovës në hendboll (femrat), Istogu, do të përballlet me skuadrën greke AEP Panorama në raundin e dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup). Istogu ishte bartës në short, ndërsa Panorama skuadra më e ulët e renditur, prandaj Istogu konsiderohet favorit. Ndeshjet luhen më 27/28 shtator dhe 4/5 tetor. Ferizaj, po ashtu në raundin e dytë, do të përballlet me Jomi

Salernon e Italisë. Ferizaj do të jetë vendas në ndeshjen e parë dhe do ta kërkojë fitoren e parë evropiane, ndonëse Salerno është skuadër e fortë. Shqiponja e Gjakovës do të luajë ndaj skuadrës zvicerane Winterthur, një kundërshtar i vështirë. Shqiponja rikthehet në garat evropiane me synimin për sukses, por shorti nuk e ka favorizuar shumë. Skuadra e katërt, Samadrexha, do të përballlet me ekipin grek PAOK, një ndër më të fortët e vazos së parë. Edhe pse përballja është e vështirë, Samadrexha do të japë maksimumin për të kaluar më tej. Të gjitha ndeshjet zhvillohen në fund të shtatorit dhe fillim të tetorit.

32 SPORTISTË PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË EYOF SHKUPI 2025

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ekipi olimpiq i të rinjve të Kosovës do të përfaqësohet në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF) Shkupi 2025. Festivali është gara më e rëndësishme e vitit për të rinj në kontinentin e Evropës, ku pjesëmarrës janë sportistë të moshës 14-18 vjeç. EYOF-i nis më 20 korrik dhe mbahet deri më 26 të të njëjtit muaj. Krahas qytetit të Shkupit, garat mbahen edhe në Kumanovë të Maqedonisë së

Veriut, ndërsa sporti i gjimnastikës zhvillohet në Osijek të Kroacisë. Listën e përbëjnë 32 sportistë (18 vajza dhe 14 djem) të 9 sporteve të ndryshme: Atletikë, çiklizëm, gjimnastikë, xhudo, taekwondo, badminton, not, pingpong dhe shenjëtari. Për ekipin tonë është pjesëmarrja e pestë në EYOF veror, ku deri më tani numërojmë vetëm një medalje të artë fituar nga atleti Muhamet Ramadani në EYOF Baku 2015.

LISTA E SPORTISTËVE

Medina Fejza, Erise Avdullahu, Loina Kadriu, Amar Maxhuni, Luan Mazrekaj, Bardh Telaku, Ledion Fetahaj, Tring Ibraj, Dionis Morina, Sara Pllana, Rea Berisha, Bora Hoti, Joana Krasniqi, Riga Kastrati, Lea Selmani, Dior Krasniqi, Nart Bakiu, Amant Sejdiu, Jona Hashani, Dhurata Ibrahim, Bled Tufa, Arianit Selimi, Alina Azemi, Resa Gashi, Imrah Vizdiklar, Blerin Gashi, Sidorela Dodaj, Enise Zijade, Riad Kasapi, Milot Gashi, Roni Reshitaj.



Rexhepi i bashkohet Kosovës U21

PRISHTINË, 15 KORRIK - Sulmuesi Rinor Rexhepi është prurja më e re te Përfaqësuesja U21 e Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Ademi ka mirëpritur Rexhepin dhe i ka uruar

mirëseardhje te Kosova, ndërsa ka shtuar se 18-vjeçari do të jetë vlerë e shtuar për “Dardanët” e rinj. Rexhepi është pjesë e ekipit Randers U19 që bën gara në Superligën e Danimarkës, kurse Kosovës do t’i bashkohet për kualifikimet e radhës. “Rinori,

sulmues qendror i Randers U19 në Superligën e Danimarkës, vjen me përkushtim, pasion dhe potencial të madh si vlerë e shtuar për grupin tonë për kualifikimet e radhës. Besojmë se ky është vetëm fillimi i një ruge të gjatë dhe të

suksesshme me fanellën dardane për Rinorin!”, ka shkruar Ademi në “Facebook”. Në 25 ndeshje të luajtura në kampionatin U19 të Danimarkës, Rexhepi ka shënuar 8 gola për ekipin e Randersit.



FFK-ja organizon kursin e radhës për Licencën C për trajnerë

PRISHTINË, 15 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës organizon kursin për trajnerë të Licencës C (UEFA C), në bashkëpunim me platformën unike të mësimdhënies dhe mësimnxënies Edubreak. Kursi do të mbahet në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, ku nga e hëna deri

të premten do të zhvillohen ligjëratat dhe stërvitjet. Pjesëmarrja e plotë është obliguese, ndërsa nuk do të ketë nevojë për akomodim dhe fjetje. Numri maksimal i pjesëmarrësve për këtë kurs është 24, ndërsa pagesa e kursit për person është 350 euro. FFK-ja ka njoftuar se

kursi fillon më 4 gusht. Kriteret për Licencën C të FFK-së janë: Aplikacionet dhe formularët e regjistrimit të FFK-së të plotësuar, dy fotografi (me përmasat e pasaportës), certifikatë shëndetësore (jo më e vjetër se gjashtë muaj), dëshmi që ai/ajo nuk është i/e dënuar

dhe nuk është nën hetime për ndonjë vepër penale, dëshmi mbi edukimin (diplomë e shkollës së mesme, së paku), minimumi i moshës së kandidatit duhet të jetë 18-vjeç. “Të gjithë të interesuarit mund t’i dorëzojnë aplikimet online deri më 31.07.2025 në adresën:



departamentiteknik@ffk-kosova.com. Aplikacionet e pakompletuara dhe ato që nuk janë skanuar mirë nuk do të merren parasysh”, thuhet në njoftimin e FFK-së.

Italia mirëpret Modriqin, legjenda kroate: Pres sfida të mëdha

MILANO, 15 KORRIK - Lëvizja e parë e bujshme e Igli Tares bëhet më në fund zyrtare: Luka Modriqi është futbollisti më i ri i Milanit, me kroatin që menjëherë pas Botërorit për Klube zbarkoi në Milano duke firmosur kontratën e re si “djall”. Modriqi firmosi deri më 30 qershor 2026 me opsion rinovimi edhe për një tjetër vit. Legjenda kroate do ta mbajë të veshur fanellën me numrin 14. Pavarësisht moshës, transferimi i Modriqit në Milano ka sjellë entuziazëm në radhët e tifozëve, për vetë faktin se konsiderohet një nga lojtarët më të mirë në rolin e tij në 15 vitet e fundit. Fituesi i “Topit të Artë” më 2018 shkroi historinë me Real Madridin ku për 13 vjet me fanellën e bardhë zhvilloi 597 ndeshje, realizoi 43 gola dhe fitoi 28 trofe, mes tyre 6 Liga të Kampionëve. I lumtur për këtë aventura të re u shfaq edhe vetë lojtari: “Jam shumë i lumtur që jam këtu. Pres sfida të mëdha”. Transferimi i tij në Serinë A pushtoi faqet e para të medieve italiane. “Modriqi firmosi. Është i arti i



Milanit”, shkruan “La Gazzetta dello Sport” në faqen e parë. “Mirë se erdhe Picasso!”, ishte titulli i përzgjedhur nga “Corriere dello Sport”. Me Modriqin tashmë të zyrtarizuar, Milani dhe Tare vijojnë punën për të tjerë objektive. Tare nuk heq dorë nga Ardon Jashari, me mesfushorin me origjinë

shqiptarë që po bën gjithçka për t’iu bashkuar në Milano. Jashari refuzoi t’i bashkohet ekipit në grumbull duke ua bërë të qartë drejtuesve të klubit dëshirën e tij. Tare nuk ndryshon kur bëhet fjalë për para, oferta e tij e fundit prej 33 milionë euro kesh plus bonuse nuk ndryshon, por kjo ofertë nuk kënaq Club Bruggen.

Sinneri dhe Swiateku triumfojnë në Wimbledon, ja si ndryshon renditja pas grand slamit

LONDËR, 15 KORRIK - Pas përfundimit të grand slamit të Wimbledonit është përpiluar edhe renditja e re e tenisistëve. Jannik Sinner dhe Aryna Sabalenka vazhdojnë të qëndrojnë në vendin e parë në kategoritë përkatëse. Italiani, fitues të dielën në Londër, thellon edhe më shumë diferencën ndaj Carlos Alcarazit, i dyti. Gati 4 500 pikë është diferenca mes tyre, por tani nis “malorja” për Sinnerin, që i duhet t’i mbrojë pikët e fituara vjet. Në podium ndodhet edhe germani Alexander Zverev (i treti), ndërkohë që mes pesë më të mirëve janë edhe amerikanët Taylor



Fritz e britaniku Jack Draper. Ruan vendin e gjashtë serbi Novak Djokoviq. Të femrat, bjellorusja Aryna Sabalenka vijon të jetë e shkëputur ndjeshëm nga rivalët, me mbi 4 500 pikë ndaj amerikanes Coco Gauff. Në vendin e tretë ngjitet Iga

Swiatek, polakja që doli fituese në Wimbledon. Në top 5 edhe Jessica Pegula e Amerikës dhe rusja Mirra Andreeva, ende një adoleshente. Fiton pesë pozicione tenisistja tjetër amerikane Amanda Anisimova, finaliste në turneun londinez.

“TOP-5” - MESHKUJ	
1. Jannik Sinner	12,030 pikë
2. Carlos Alcaraz	8,600
3. Alexander Zverev	6,030
4. Taylor Fritz	5,035
5. Jack Draper	4,650
“TOP-5” - FEMRA	
1. Aryna Sabalenka	12,420 pikë
2. Coco Gauff	7,669
3. Iga Swiatek	6,813
4. Jessica Pegula	6,423
5. Mirra Andreeva	5,163

Hendersoni paraqitet te Brentfordi

Jordan Henderson është rikthyer zyrtarisht në Ligën Premierë pasi Brentfordi njoftoi për nënshkrimin e lojtarit të kombëtares angleze. 35-vjeçari anglez ka nënshkruar një kontratë të vlefshme deri në

qershorin e vitit 2027 me klubin e njohur të Ligës Premierë. “Brentfordi mund të konfirmojë nënshkrimin e kapitenit fitues të Ligës Premierë dhe Ligës së Kampionëve, Jordan Henderson,

me një kontratë dyvjeçare”, thuhet në një deklaratë të klubit. Hendersoni, një lojtar i kombëtares angleze me 84 paraqitje për “Tre Luanët”, u bashkua me “Bletët” si transferim i

lirë pasi u largua nga Ajaxi këtë verë. Mesfushori kthehet në Ligën Premierë pas periudhave të shkurta në Arabinë Saudite me Al-Ettifaq dhe më pas në Holandë me Ajaxin. Para kësaj, Hendersoni

ishte me Liverpoolin, ku kaloi 12 vjet dhe fitoi Ligën Premierë, Ligën e Kampionëve, Kupën FA, dy Kupa të Ligës, Community Shield, Superkupën dhe Kupën e Botës për Klube.

SHKURT

Kastrati rikthehet te KB Ylli

Pasi tri vite me KB Trepça, basketbollisti i kombëtares së Kosovës, Erjon Kastrati ka vendosur që karrierën ta vazhdojë në Suharekë, tek Golden Eagle Ylli. Ylli këtë sezon ka bërë një super ri-organizim të klubit dhe në radhët e veta e ka rikthyer ish-basketbollistin e vet, ku shkroi histori me këtë klub. Erjoni për Yllin ishte paraqitur në sezonin 2020/21 dhe 2021/22, ku ishte faktori kyç në triumfet e Yllit në kampionat. Lajmi është bërë i ditur nga vetë faqja zyrtare e klubit përmes një postimi në rrjetin social “Facebook”. Suharekasit kanë nënshkruar kontratë tre-vjeçare me basketbollistin. 30-vjeçari është kampion i Kosovës katër herë në pesë vitet e fundit, pikërisht dy herë me Yllin, dhe po ashtu dy tituj tjerë me Trepçën.

Kumbulla largohet nga Spanja, kthehet në Itali

Marash Kumbulla u rikthye në klubin e qytetit të tij të lindjes pas një sezoni të suksesshëm si huazim te Espanyol. E ardhmja e tij është e pasigurt, por qendërmbrojtësi shqiptar dëshiron t’i luajë letrat e tij siç duhet. Qëllimi është të krijojë një rol të rëndësishëm në skuadrën e Romës dhe ndeshjet parasezonale do të jenë mundësia e përsosur për të bindur trajnerin Xhan Piero Gasperini. Duke qenë se nevojja për mbrojtës të Roma është aktuale, shqiptari kërkon shansin e tij për të treguar vlerat.

Marquez: Fitova pa rrezikuar

Marc Marquez shijon triumfin e radhës sezonit pas një gare pa histori në Saksenring, në të cilën dominoi ndaj rivalëve që prej startit e deri në mbërritjen në finish. “Thjesht, pata një ritëm të shkëlqyer”, ishin fjalët e para të Marquezit për “Sky”, menjëherë pasi kishte shënuar suksesin në Çmimin e Madh të Gjermanisë, “Ndihesha shumë mirë në motor, jam shumë i lumtur. E ruajta ekuilibrin në fillim, duke u larguar për të dhjetat e sekondës pa u përpjekur të krijoja një diferencë të madhe menjëherë, dhe pastaj duke i menaxhuar gjërat drejt fundit. Të shtunën, në shi, rrezikova dyfish, por në garë sot gjithçka ishte nën kontroll”, u shpreh ndër të tjera lideri i Kampionatit Botëror të Moto GP-së.

Allister dëshiron t’i bashkohet Realit

Alexis Mac Allister është kthyer në objektivin kryesor të Real Madridit, që synon të bëjë një goditje të madhe në merkato për të përforcuar mesfushën, repart që nuk është më i njëjtë pas largimit të emrave me peshë si Toni Kroos verën e kaluar dhe Luka Modriqi këtë verë. Ndaj, drejtuesit e Real Madridit po ndjekin disa emra, por në krye të listës është Alexis Mac Allister, pasi Vithina i PSG-së duket i paarritshëm. Interesi i Realit ndaj mesfushorit argjentinas të Liverpoolit nuk është i rastësishëm, pasi është edhe dëshira e vetë lojtarit për t’u transferuar në Madrid. “Defensa Central” raporton se Alexis Mac Allister mendon vetëm për Real Madridin, ndaj dhe ka refuzuar propozimin e ardhur këtë merkato nga Bayern Munchen. Momentalisht, argjentinas është i foksuar te Liverpooli, por nuk e fsheh dot pëlqimin për Real Madrid. Sipas raportimit në fjalë, nëse Real Madrid nuk ia del dot ta transferojë këtë merkato, do bëjë të pamundurën për të sjellë Mac Allister në Madrid, verën e ardhshme.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com,
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjobiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të **Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:**

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor	Studime Master
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)	1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)	2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)	
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)	
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)	

- Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:
- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
 - Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
 - Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
 - Ekstrakti i lindjes;
 - Kopje e letërnjoftimit;
 - 2 fotografi (formati pasaportë)

- Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:
- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
 - CV
 - Certifikatën e lindjes
 - Kopjen e letërnjoftimit
 - Dy foto
- 038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi.**
Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.
Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**
Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjobiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjobiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjobiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Mishtore Dreni” –“Shaban Spahija” B.I., Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Thertoren për therjen e kafshëve të trasha dhe të imta të mishit dhe përpunimit në Mirushë, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.08.2025 në ora 10:00 në Objektin e SHFMU "Ibrahim Mazreku" Malishevë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Mishtore Dreni” –“Shaban Spahija” B.I., Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM
<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkdVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Mishtore Dreni” –“Shaban Spahija” B.I., Malishevë, për Pëlqim Mjedisor, – për Thertoren për therjen e kafshëve të trasha dhe të imta të mishit dhe përpunimit në Mirushë, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shaban Morina shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore në Kushnin, Has, komuna e Prizrenit.

- Shkurte Morina shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Shtjefën Gjeqovi”, Zym i Hasit, Prizren.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Binak Likaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës “Shtjefën Gjeqoni”, në Krajk-Has, Prizren.

- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044\171-328.

- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM “Dr. Xheladin Deda”.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044\262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044\558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

